



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KRITERET PARAPRAKE PËR THIRRJEN:**

**SHPALLJE NJOFTIMI PËR 3 (TRE) VENDE TË LIRA PUNE, 2 (DY) VENDE NË QENDRËN E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE POGRADEC DHE 1 (NJË) VEND NË QENDRËN E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE KORÇË, PËR PERIUDHËN SHTATOR 2023-SHKURT 2024**

Komisioni për zhvillimin e procesit të konkurimit për 3 (tre) vende të lira pune, 2 (dy) vende në Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec dhe 1 (një) vend në Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë, për periudhën Shtator 2023-Shkurt 2024, ngritur me urdhër nr. 373 datë 18.08.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, u mbledh më datë 04.09.2023, me qëllim shqyrtimin e aplikimeve, sa i përket përmbushjes së kërkesave të posaçme dhe dokumentacionit sipas thirrjes së publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas<sup>1</sup> si dhe në bazë të Urdhrit nr. 53 datë 26.05.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas «Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore».

Nga verifikimi në protokoll, rezulton se për vendet vakante pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec kanë shprehur interes **2 (dy) aplikantë** në rend alfabetik si vijon:

1. **Zj. Jona Loli** (kërkesa me nr. 1730 prot., datë 04.09.2023, me anë të shërbimit postar);
2. **Zj. Olgerta Demelli** (kërkesa me nr. 1719 prot., datë 01.09.2023, me anë të shërbimit postar);

Ndërsa, për vendin vakant pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë ka shprehur interes **1 (një) aplikante** si vijon:

1. **Aurora Simaku** (kërkesa me nr. 1718 prot., datë 01.09.2023, me anë të shërbimit postar);

**Pas shqyrtimit të dosjeve personale të aplikantëve, sipas metodologjisë së vlerësimit, Aneks-it 1 të miratuar me urdhërin nr. 53, datë 26.05.2021 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës parësore”, komisioni vendosi që aplikantët të cilët plotësojnë kriteret për të vazhduar procesin e konkurimit (sipas rendit alfabetik) janë:**

1. **Zj. Jona Loli;**
2. **Zj. Olgerta Demelli.**

<sup>1</sup> <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/vende-vakante/>

**Pas shqyrtimit të dosjeve personale të aplikantëve, sipas metodologjisë së vlerësimit, Aneks-it 1 të miratuar me urdhërin nr. 53, datë 26.05.2021 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës parësore”, komisioni vendosi që aplikanti i cili nuk plotëson kriteret për të vazhduar procesin e konkurimit është:**

1. **Aurora Simaku** (Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar, Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore në formën e kërkuar (të vulosur/ të nënshkruar elektronikisht ose në format të njehsuar me origjinalin, si dhe brenda tre muajve nga momenti i lëshimit nga Institucioni përkatës.))

Aplikantët e kualifikuar për shpalljen: Njoftim për 3 (tre) vende të lira pune, 2 (dy) vende në Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec dhe 1 (një) vend në Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë, për periudhën Shtator 2023-Shkurt 2024, duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas për t’u nënshtruar provimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

❖ **Provimi me shkrim** do të zhvillohet më datë **07.09.2023, ora 11:00**, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

*Provimi me shkrim do të zhvillohet mbi:*

- Njohuri të thelluara mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Ligjinnr.111/2017, kushtet dhe kërkesat e ligjit për të përfituar nga shërbimet e ndihmës juridike falas;
- Njohuri të plota teorike dhe praktike mbi legjislacionin dhe të drejtën civile, penale dhe administrative.

❖ **Intervista e strukturuar me gojë** do të zhvillohet më datë **07.09.2023, ora 12:30**, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

*Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet mbi:*

- Njohuritë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e punës, eksperiencën e mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

*Mos paraqitja e kandidatëve në datën e orën e caktuar passjell skualifikimin.*

**Adresa:** Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Rruga “Jordan Misja”, Njësia Bashkiake nr. 9, Godina nr.3, Tiranë